REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH
DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCËS E TË ARDHURAVE VENDORE
SEKTORI I TË ARDHURAVE VENDORE

Nr.________.prot                                                                Belsh më.______.______.2024

**PROJEKT-VENDIM**
**Nr.______.Datë.____.____.2024**

**"PËR KALIMIN E TREGUT TË SË SHTUNËS NË UNAZË NGA RRUGA E "QAFSHKALLËS" DERI TE KRYQËZIM I I FSHATIT "PRROI ZI"**

Në mbështetje të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*"; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; nenit 4/1 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin territorit*" (i ndryshuar); nenit 15, pika 3 të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*"; neni 35 i ligjit 9632,datë 30/10/2006 "*Për sistemin e Taksave Vendore në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar.

**PROPOZOIM:**

1. Të bëhet kalimi i tregut të Belshit në aksin rrugor "Unaza" nga rruga e Qafshkallës deri te kryqëzimi i fshatit Shkëndi(Përroi zi)
2. Hapsira midis dy kryqëzimeve për ditën e shtunë të shfrytezohet si Hapesirë Publike.
3. Rruga Qafshkall dhe rruga Përroi Zi do të jenë të lira për levizjen e mjeteve.
4. Tarifa e shërbimit në tregje është sipas VKB nr.76.datë 29.12.2024.

**Konceptoi:**
**P/Tatim-Taksave**
Ditjon Pepa

**Juristi:**
Desara Musta

**KRYETARI**
**Arif Tafani**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

***SEKRETAR I PËRGJITHSHËM***
**Mustafa Çarçiu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA BELSH

Adresa: Qarku Elbasan, Belsh Qender, Rruga Haziz Dervishi,                bashkiabelsh@hotmail.com

80 VJETORI I ÇLIRIMIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH
DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCËS E TË ARDHURAVE VENDORE
SEKTORI I TË ARDHURAVE VENDORE

Nr.________.prot Belsh më.________.________.2024

**Relacion shpjegues:**

Mbështetur në kërkesat e vazhdueshme te qytetarve të Bashkisë Belsh dhe të tregtarve të Bashkisë Belsh, të cilet u zhvendosen nga Qendra e Belshit, ku tregtonin më perpara, në tregun e Marinzes "Tregu agroushqimor".
Duke parë që ky treg nuk është funksjonal menduam tu vijmë në ndihmë qytetarve duke e afruar me afer qytetit tregun ditorë të së shtunës.
Propozojmë që tregu te kryhet në aksin në "Unazë" midis kryqezimit te Qafshkallës dhe kryqezimit te Prroit Zi si zgjidhje per qytetaret dhe për tregtaret ne Bashkinë Belsh, pasi pjesa e rrugës e cila ka qëne shfrytëzuar më përpara për tregun ditorë të së shtunës "*Rruga Qendër-Rruga e Rrases*", ka qene bllokim per lëvizjen e mjeteve te transportit dhe levizjen e lire te qytetarve, e cila nuk ishte e përshtatëshme dhe ndikonte negativisht edhe për viziorët që ka Bashkia Belsh si destinacion turistik.
Kjo pjese e Unazes nuk përbën pengesë bllokim për levizjen e lirë të mjeteve(*ambulanca, policia, dhe mjete te qytetarve*).
Nisur nga cfare kemi shkruar më lart,ne si zyrë e tatim taksave i propozojmë këshillit bashkiak miratimin e projekt vendimit për lëvizjen e tregut.

Ju Faleminderit!

**Koncептoi:**
**P/Tatim-Taksave**
Ditjon Pepa

Adresa: Qarku Elbasan, Belsh Qender, Rruga Haziz Dervishi, bashkiabelsh@hotmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

DREJTORIA E SHERBIMEVE ARSIMORE, KULTURES, RINISE DHE SPORTEVE

ZYRA E ARSIMIT

Nr.____Prot 4474

Belsh më 10/12/2024

## PROJEKT – VENDIM
**Për miratim trualli per ndertimin e kopshtit**

Mbështeturnëligjin nr. 139më dt.17.12.2015 "Për vetqeverisje vendore"I ndryshuar,në ligjin nr.69 datë 21/06/2012 "Për sistemin Arsimorë Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" I ndryshuar. Duke u nisur nga numri i larte i femijeve qe frekuentojne kopshtin dhe pamundesine per nje ambjent te pershtatshem ku femijet te plotesohen me te gjitha njohurit dhe nevojat qe kane ata gjate frekuentimit te kopshtit, nisur edhe nga kerkesat dhe ankesat e vazhdueshme te prinderve per nje godine te re sipas te gjitha standarteve :

Zyra e Arsimit i propozon Këshillit Bashkiak Belsh:

**Propozim**

Të miratojë propozimin për miratimin e truallit per ndertimin e kopshtit në një nga këto tre prona publike:

1-Ngritjen e katit të dytë te objektit ekzistues, Kopshti Publik Belsh.

2-Prona te ish qendra kulturore e femijeve,duke prishur objektin ekzistues dhe ndertimin e kopshtit dhe ambjenteve ndihmese (pasi objekti eshte drejt rrenimit)

3-Ndertimin e nje kopshti te ri te aneksi I fushes se futbollit, prona nr.340 Transferuar ne perdorim Bashkise Belsh.

ZYRA E ARSIMIT

Orjeta NIPOLLI

KRYETARI BASHKISE

Arif TAFANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BELSH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

DREJTORIA E SHERBIMEVE ARSIMORE,KULTURES, RINISE DHE SPORTEVE

ZYRA E ARSIMIT

Nr.____Prot Belsh më 10/12/2024

## RELACION DREJTUAR KESHILLIT BASHKIAK

**Hyrje**

**Arsimi parashkollor eshte nje hallke e rendesishme e sistemit Arsimor Parauniversitar.Ky cikel arsimor zbaton nje kurrikul te re bazuar ne standarte permbajtjeje,standarte arritjeje si dhe programe studimi teresisht te reformuara te cilat synojne te integrojne natyrshem femijen ne procesin e edukimit dhe te zhvillimit, duke e motivuar per te vijuar natyrshem rrugen e gjate te te nxenit.**

**Ndertimi I nje godine te re per nje kopesht per femije eshte nje investim I rendesishem per permiresimin e sherbimeve arsimore dhe sociale per komunitetin. Qellimi kryesor eshte krijimi I nje hapesire te sigurt,moderne dhe te pershtatshme per edukimin dhe zhvillimin e femijeve te moshes parashkollore.**

**Objektivi: Te plotesohen kerkesat ne rritje per regjistrimin e femijeve ne kopshte duke ofruar ambjente te reja dhe te pajisura me standartet me te larta.**

**Nevoja: Godina aktuale eshte e pamjaftueshme per t'iu pergjigjur kerkesave dhe nevojave te komunitetit lokal.**

**Pronat publike qe ne propozojme jane:**

**1-Kopshti Publik Belsh Qender,ngritja e katit te dyte tek objekti ekzistues,(ku te behet vleresimi I konstruktoreve per qendrueshmerine)**

**2-Prona tek ish qendra kulturore e femijeve(Vatra e kultures) duke prishur objektin ekzistues dhe ndertimin e kopshtit nga e para pasi gjendja objektit eshte drejt rrenimit.**

**3-Ndertimin e kopshtit te ri tek aneksi I fushes se futbollit. Prona me nr.340 Transferuar ne perdorim Bashkise Belsh.**

Baza ligjore :

Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisje vendore"I ndryshuar.Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë ,si dhe përcakton funksionet , kompetencat,të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse. Ligji nr.69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar" I ndryshuar, neni 28 "Njesia baze e qeverisjes vendore",pika 2.

**Kërkojmë nga Këshilli Bashkiak që të na miratojë këtë Projekt-Vendim të hartuar nga zyra jonë ,në lidhje me propozimin për miratimin e truallit per ndertimin e kopshtit.**

**ZYRA E ARSIMI**
**Orjeta NIPOLLI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

Nr. 4356 prot. Belsh më 02.12.2024

**PROJEKT –VENDIM**
**Nr – Datë 02/12/2024**

**"MIRATIMI NË PARIM I KONTRATËS SË QIRASË PËR PËRDORIMIN E PALESTRËS SË SHKOLLËS "SAMI FRASHËRI" PËR ZHVILLIMIN E KURSEVE TË VOLEJBOLLIT"**

Bazuar në Ligjin Nr.139 date 17.12.2015 "*Per vetqeverisjen vendore* ",te ndryshuar ,Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisëi ndryshuar,VKM-ja Nr. 54 date 05.02.2014 "Për Përcaktimin e Kritereve , të Procedurës dhe të Mënyrës së Dhënies me Qira, Enfiteoze apo Kontrata të tjera të Pasurisë Shtetërore" të ndryshuar, Ligj nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar , si dhe duke u bazuar në kërkesën Nr.3163Prot.datë 20.09.2024 të Znj.Fiorenca Hysa.

**PROPOZOJMË**

Të miratohet në parim i dhënies me qira të palestrës së shkollës "Sami Frashëri" për zhvillimin e kurseve të volejbollit nga Znj.Fiorenca Hysa me dokument identifikimi K25802003L,3 herë në javë pasdite me një afat 1 vit me të drejtë rinovimi.

*Bashkangjitur këtij projekt-vendimi:*
Relacion shpjegues.

**KRYETARI I BASHKISË**
**Arif TAFANI**
(Në mungesë dhe me urdhër)
Sekretari i përgjithshëm
**Mustafa Çarçani**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BELSH

Nr.__________prot. Belsh më: . .2024

# RELACIONI

## MIRATIMI NË PARIM I KONTRATËS SË QIRASË PËR PËRDORIMIN E PALESTRËS SË SHKOLLËS " SAMI FRASHËRI" PËR ZHVILLIMIN E KURSEVE TË VOLEJBOLLIT"

***Drejtuar: Këshillit Bashkiak Belsh***

***Të nderuar këshilltar!***

Bashkia Belsh ne kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj një ndër të cilat është dhënia me qira të pasurive pasurive për ushtrimin e aktivitetesh të ndryshme nga persona fizik dhe subjekte konform legjislacionit.

**Baza ligjore**

-Bazuar në Ligjin Nr.139 date 17.12.2015 "*Per vetqeverisjen vendore* ",te ndryshuar

-Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar,

-VKM-ja Nr. 54 date 05.02.2014 "Për Përcaktimin e Kritereve , të Procedurës dhe të Mënyrës së Dhënies me Qira, Enfiteoze apo Kontrata të tjera të Pasurisë Shtetërore" të ndryshuar,

- Ligj nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar ,

-Bazuar në kërkesën e subjektit Znj.Fiorenca Hysa Nr.3163Prot.datë 20.09.2024 i cili kërkon te shfrytëzojë palestrën e shkollës "Sami Frashëri " në Bashkinë Belsh me siperfaqe 200 $m^2$ për ushtrimin e aktivitetit sportive (kurse volejbolli) .

Palestra është një pronë publike në administrim të Bashkisë Belsh,e cila aktualisht perdoret vetëm gjatë orëve të mësimit dhe ka potencialin për të mbështetur aktivitete te tjera sportive në orët e pasdites .Kjo do të siguroje një ambjent të shëndetshëm dhe aktiv për të rinjtë e komunitetit.

Qëllimi i këtij projekt-vendimi është të ofrojë mundësi për zhvillimin e aktiviteteve sportive për të rinjtë dhe të rrisë angazhimin e tyre në aktivitete të dobishme për shëndetin dhe mirëqenien.

Dhënia me qira e palestrës do të kontribuojë në:

-Përdorimin efektiv të pronave publike.

-Promovimin e sportit dhe aktivitetit fizik për të rinjtë.

-Sigurimi i një burimi të ardhurash për Bashkinë nëpërmjet tarifës..

***Kushtet e kontratës***

***Propozohen kushte si më poshtë***

Palestra do të përdoret tri herë në javë,pasdite.

Duke u bazua ne VKM Nr.54 date 05.02.2014 "Për Përcaktimin e Kritereve , të Procedurës dhe të Mënyrës së Dhënies me Qira, Enfiteoze apo Kontrata të tjera të Pasurisë Shtetërore" të ndryshuar, janë parashikuar në tabelën A "*tarifat dysheme të qirasë mujore për ndërtesat sipas qarqeve*" nga e cila rezuiton se , Tarifa për qiranë do të jetë 15 000 lekë në muaj.

-Qiramarrësi do të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e palestrës dhe respektimin e rregullave të shkollës.

Nga sa me sipër kërkojmë të miratohet në parim kërkesa për dhënien me qira të palestrës së shkollës ne favor të subjektit Znj.Fiorenca Hysa .Kjo do të sjellë përfitime për të rinjtë dhe do të kontribuojë në zhvillimin e aktiviteteve sportive në komunitet.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

Konceptuan:

**Specialist Juriste**
Desara Musta

**Përgjegjëse Arsimit**
Orieta Nipolli

***Bashkangjitur:***
Kërkesa e subjektit

**KRYETARI I BASHKISË**
**Arif TAFANI**
(Në mungesë dhe me urdhër)
Sekretari i përgjithshëm
**Mustafa Çarçiu**

R. E SHQIPERISE- BASHKIA BELSH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BELSH**

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE E TË ARDHURAVE VENDORE**

**ZYRA E NDIHMËS EKONOMIKE**

**Nr.4487Prot.** **Belsh më 10.12.2024**

## PROJEKT-VENDIM

**Për propozim për dhënien e Ndihmës Ekonomike për periudhën 01.11.2024 - 30.11.2024**

Bazuar në nenin 21 të ligjit nr 9355,datë 10.03.2005, i ndryshuar me Nr 57/2019 "Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore",i ndryshuar i cili parashikon që "Këshilli i Bashkisë Belsh ka të drejtë të miratojë kritere specifike për dhënien e ndihmës ekonomike me fondet e buxhetit vendor,dhe deri në 6% të fondit te kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike për familjet me më shumë pjestarë ose familjet në nevoje ".Zyra e ndihmës ekonomike bazuar dhe në verifikimet e bëra nga ana jonë **propozojmë dhe konkludojmë** të përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin **NËNTOR 2024 për Bashkinë** ,me një fond për 21 **familje ,** një fond prej 80846 **lekë.**

**Fondi i Bashkisë për familjet në nevojë .**

Lista e familjeve të cilat ne propozojmë të përfitojnë ndihmë ekonomike janë familje ekstremisht të varfëra dhe nuk janë përzgjedhur për të përfituar nga sistemi pilot i NE për shkak të sistemit të ri të pikëzimit.

**PËRGJEGJËSE NE**

**Entela DERVISHI**

**KRYETARI I BASHKISË**
**Arif TAFANI**
NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
**Mustafa ÇARÇIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA BELSH

**Bashkia BELSH**

Lista e bordoros NËNTOR 2024 Projekt-Vendimit në total të familjeve të propozuara për të përfituar me 6% e fondit të bllok-ndihmës për periudhën **1-30.11.2024**

| Nr | Njësia Administrative | Numri familjeve | Fondi |
|---|---|---|---|
| 1 | Belsh | 11 | 38930 |
| 2 | Grekan | 6 | 19286 |
| 3 | Kajan | 3 | 18196 |
| 4 | Rrasë | 1 | 4434 |
| 5 | Fierzë | 0 | 0 |
| | **Totali** | **21** | **80846** |

**PËRGJEGJËSE NE**

**Entela DERVISHI**

**KRYETARI I BASHKISË**
**Arif TAFANI**
NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
**Mustafa ÇARÇIU**

LISTËPAGESA E PERSONAVE QË PAGUHEN NË SKEMËN E 6 % PËR MUAJIN NËNTOR 2024

| Nr | Emri i Aplikantit | NID Admin parave | Vlera e përllogaritur | KE | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Fitnet Qazim Shtylla | G95228224W | 2178.00 | 1288.00 | 3466.00 |
| 2 | Ruzhdi Shyqyri Bali | H05203007C | 3703.00 | 1288.00 | 4991.00 |
| 3 | Besim Riza Sina | F85525018E | 2178.00 | 1288.00 | 3466.00 |
| 4 | Fitnet Shefqet Dervishi | G15406015O | 3146.00 | 1288.00 | 4434.00 |
| 5 | Hava Sherif Uruçi | G35501007D | 3146.00 | 1288.00 | 4434.00 |
| 6 | Sajde Ymer Paja | H05201011U | 2178.00 | | 2178.00 |
| 7 | Fatmir Livan Kasa | G55820014A | 2178.00 | 1288.00 | 3466.00 |
| 8 | Kujtim Ramazan Ahmeti | G76208004L | 1525.00 | | 1525.00 |
| 9 | Edlira Ferit Muça | H85202013D | 1525.00 | | 1525.00 |
| 10 | Jeta Xhevit Sina | H05728210N | 1525.00 | | 1525.00 |
| 11 | Yllka Iljas Braho | I65202001C | 7920.00 | | 7920.00 |
| 12 | Anxhela Shefqet Senia | J66104014U | 5940.00 | | 5940.00 |
| 13 | Haxhi Ali Qypi | G45213013H | 1525.00 | | 1525.00 |
| 14 | Andra Shpëtim Koçiu | J15506025E | 1980.00 | | 1980.00 |
| 15 | Ervina Shpëtim Koçiu | J35425019I | 3960.00 | | 3960.00 |
| 16 | Myzejen Hazis Senia | G55629011P | 2178.00 | | 2178.00 |
| 17 | Bajram Mersin Skënderi | H15531094H | 3703.00 | 0.00 | 3703.00 |
| 18 | Rajmonda Ardjan Rusta | J55202010B | 5940.00 | | 5940.00 |
| 19 | Florenc Ali Elezi | I26103008M | 6316.00 | | 6316.00 |
| 20 | Sonila Yzeir Koçiu | J85221010H | 5940.00 | | 5940.00 |
| 21 | Manushaqe Rrap Elezi | G45125015L | 3146.00 | 1288.00 | 4434.00 |
| 21 | | | 71830.00 | 9016.00 | 80846.00 |

**PËRGJEGJËSE NE**
**Entela DERVISHI**

P. [signature]

**KRYETAR I BASHKISË**
**Arif TAFANI**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
**Mustafa ÇARÇIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA BELSH

*Adresa: Qarku Elbasan, Belsh Qender, Rruga Haziz Dervishi,* bashkiabelsh@hotmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BELSH**

**Nr** 4510 **prot** **Belshmë:** 10/12/ **2024**

**PROJEKT –VENDIM**
**"PËR DHËNIEN NE PËRDORIM TE SIPËRFAQES SË CAKTUAR TË FONDIT PYJOR/KULLOSOR PUBLIK NË PRONËSI TË BASHKISË BELSH"**

Bazuar në Ligjin Nr.139 date 17.12.2015 "*Per vetqeverisjen vendore* ",te ndryshuar, Ligjin **Nr. 57/2020''Për Pyjet'',** Ligjin nr. 48/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005"Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor", të ndryshuar, VKM nr.433,date 08.06.2016,''Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-komunave/bashkive'',VKM nr.684 date 02.09.2020 " Per transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike",Vendim nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", si dhe Vendimin nr. 888, datë 27.12.2022 " Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre",, Udhëzimit Nr. 1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, te shqyrtimit e te miratimit te kërkesave për dhënien ne përdorim te fondit pyjor dhe kullosor publik", *i ndryshuar,* Raportin tekniko-ekonomik" Raport mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim të një sipërfaqe te caktuar te fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Belsh", me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtoria Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve dhe Mjedisit, Pronave Publike ju,

**PROPOZOJMË:**

1.Miratimin për dhenien në përdorim të siperfaqes nga fondi të pasurise "A" pjese e pasurise Nr. 185/1, ZK. 1146, me adresa e pasurisë, Belsh-Hysë, lloji i pasurisë Kullotë, me sipërfaqe 77 000 m$^2$ në pronësi të Bashkisë Belsh, per "*Agropylltari*".

2. Miratimin për dhenien në përdorim të siperfaqes nga fondi të Pasuria "B" nr. Pasurie 122/1 zona kadastrale 3272 , Fshati Seferan, lloji i pasurisë Kullotë, me sipërfaqe 16 300 m$^2$ në pronësi të Bashkisë Belsh,per "*Agropylltari*".

3.Afati i dhënies në përdorim me qira të siperfaqes do të jete 9 vjet, me të drejtë rinovimi të kontratës së qirasë sipas dispozitave ligjore në fuqi.

4.Efekti: Jep një impakt pozitiv në komunitet duke hapur vende te reja pune, di dhe sigurohen të ardhura për bashkinë, që kthehen në investime publike.

5. Vlera vjetore e dhënies me qira do te jete sipas VKM-se nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", shtojca nr.1 pika 8, në afatin 6-10vjet.
6. Pas miratimit në Këshillit dhe shprehja e ligjshmërisë nga ana e prefektit të qarkut, do të vazhdohet procedura për dhënien ne përdorim të kësaj pasurie me anë të konkurimit publik duke bërë shpalljen në Buletinin e Njoftimeve Publike sipas afateve ligjore, në mbështetje të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 01. datë 09.06.2016. për "*Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik*".

**Konceptuan:**
**P/Sektori i Pronave Publike**
**Anxhela Dervishi**
**Juristi**
**Desara MUSTA**

**KRYETARI I BASHKISË**
**Arif TAFANI**

(Në mungesë dhe me urdhër)
Sekretari i përgjithshëm
**Mustafa ÇARÇIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA BELSH**

**Nr_________prot** **Belshmë: __/__/ 2024**

**RELACION**
**"PËR DHËNIEN NE PËRDORIM/HEQJE TE SIPËRFAQES SË CAKTUAR TË FONDIT PYJOR/KULLOSOR PUBLIK NË PRONËSI TË BASHKISË BELSH"**

**Drejtuar: Këshillit Bashkiak Belsh**

**Të nderuar këshilltar!**

Bashka Belsh në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të cilat është administrimi i fondit pyjor dhe kullosor ne territorin e Bashkisë Belsh, sipas legjislacionit ne fuqi. Pjesë e administrimit- menaxhimit është dhënia në përdorim/me qera e pasurive për ushtrimin e aktivitetesh të ndryshme nga persona fizik dhe subjekte konform legjislavcionit të pyjeve e kullotave.

**Baza ligjore:**

-Ligjin Nr .139 datë 17/12/2015 "Për vetëqeverisjen vendore "
-Ligjin nr. 115/2014 dt. 31. 07.2014 " Për Ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në RSH ",
-Ligjin **Nr. 57/2020 "Për Pyjet",**
-Ligjit nr.9385, date 04.05.2005,"Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar ,
-Ligji nr 8744 dt 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar,
-VKM nr.433,date 08.06.2016 ,"Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-komunave/bashkive",
-VKM nr, 684 date 02.09.2020 " Per transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike"
-Vendim nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", bashkia ka për qëllim administrimin dhe rritjen e vleres se pronave publike .
-Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 01. datë 09.06.2016. për "*'Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik*".

Sipërfaqjet qe propozohen te jepet ne përdorim jane :

- Dhenien në përdorim të pasurise A pjese e pasurise Nr. 185/1, ZK. 1146, me adresa e pasurisë, Belsh-Hysë, lloji i pasurisë Kullotë, me sipërfaqe 77 000 $m^2$ në pronësi të Bashkisë Belsh, "**Agropylltari**".

Formulari4

| Perdorim ii | Sip.Ha | Bashkia | Volumi m3 | Vlera | | Gjatesia | Tarifa dhenie ne perdorim | | | Sh |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | lek/m | Shuma I | Perd.km | 1 | 2 deri5 | 6 deri10 | |
| **0** | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | |
| imesi pyjore | 7.7 | Belsh | 0 | 0 | 0 | 0 | 115 500 | 100 100 | 77 000 | 0 |
| **Gjithesej** | 7.7 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 115 500 | 100 100 | 77 000 | 0 |

- Dhenien në përdorim të pasurise B pjese e pasurise Nr. 122/1, ZK.3272, lloji i pasurisë Kullotë, me sipërfaqe 16 300 $m^2$ në pronësi të Bashkisë Belsh, "**Agropylltari**".

( Agropylltari)

| Perdorimii territorit | Sip.Ha | Bashkia | Volumi m3 sipas asortimenteve | Vlera | | Gjatesia | Tarifa dhenie ne perdorim lek/ha/v | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | lek/m3 | Shuma | Perd.km | 1 | 2 deri5 | 6 deri10 |
| **0** | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** |
| Bimesi pyjore | 1.63 | Belsh | | | | | 24 450 lekë | 21 190 | 16 300 |
| **Gjithesej** | | | | | | | 24 450 lekë | 21 190 | 16 300 |

Bazuar ne Vendimin nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".
Dhënia në përdorim kundrejt kontratës së qerasë vjetore është në interes jo vetëm të rritjes së të ardhurave të bashkisë duke sjelle investime dhe përmirësimin e infrastrukturës.

Shprehja e dakortësisë për dhënien në përdorim të sipërfaqeve u mundëson subjekteve te interesuara të plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm për këtë qëllim bazuar në legjislacionin në fuqi me anë të procesit te konkurrimit publik dhe të kërkresaveUdhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 01. datë 09.06.2016. për "*'Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik*".

**Bashkangjitur po ju dërgojmë:**

-Raportin tekniko- ekonomik si dhe dokumentacion e plote dhe harten kadastrale.

Duke ju falenderuar, ju ftojmë në miratimin e projekt-vendimit.

**P/Sektori i Pronave Publike**
Anxhela Dervishi

**Bashkia BELSH**

Nr 4509 prot
10/12/2024

*Shtojca nr. 1*

# RAPORT

## MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM/HEQJE NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TËSIPËRFAQEVE NË PRONËSI TË BASHKISË BELSH.

( Agropylltari)

Bazuar në Urdhërin nr. 262 me nr.4475 prot datë 10.12.2024 të Kryetarit të Bashkise për studimin tekniko-ekonomik per dhenien ne perdorim nga fondi pyjor dhe kullosor te siperfaqes ne pronesi te Bashkise Belsh . Grupi I punes i perbere nga Z.Qemal Rusta Specialist Bujqesie, Z.Klodian Ganҫi inxhinier I pyjeve,
Znj. Anxhela Dervishi Pergjegjese e pronave publike, Znj.Bukuroshe Allka Pergjegjese ne sektorin e Bordit te Kullimit, Z.Bardhyl Sina Specialist Bujqesie ne daten 10.12.2024 realizoi verifikimin në terren, të kesaj sipërfaqe kullosore.

Mbështetur në VKM.684 dhe sipas vendimit te keshillit Bashkiak NR. 15 date 29.02.2024 miratimi i Planit te Rilevimit per pasurine qe jepet me qera Pasuria "B" pjese e Çertifikates se pronesise me nr. Pasurie 122/1 zona kadastrale 3272 , Fshati Seferan , Bashkia Belsh rezulton që sipërfaqja eshte 1.63ha, dhe shtrihet në ngastrat/nëngastra/19/a; bën/bëjnë pjesë në ekonomitë pyjore/kullosore Rrase-Xherije dhe jane ne pronesi/administrim te Bashkise Belsh.

Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj, pasqyrohen në aneksin 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: *(sipas tabelave perkatese te bashkelidhura).*

Siperfaqen qe do te jepet ne perdorim do ta gjeni te specifikuar ne tabelat e meposhtme.

Ky raporte eshte hartuar ne mbeshtetje te ligjit nr.139/2015 Per Veteqeverisjen Vendore,ligjit nr.57/2020 Per Pyjet,Vkm nr.684/2020 Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve e kullotave publik Vendimi Nr. 888, datë 27.12.2022 per rastet e dhenie ne perdorim dhe per ndryshimin e kategorise se perdorimit, procedurat dhe dokumentacioni perkates per ndryshimet e siperfaqeve, në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr. 01 datë 09.06.2016" "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik",

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve te tjera normative si më sipër, shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur, vetëm pas lidhjes së kontratës me bashkinë dhe likujdimit të tarifës prej _______lekë.

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-ve nr.559, datë 29.07.2022 " Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shyrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e perdorimit.

Shuma në lek/vit konsiston në:

| 5. Agropylltari | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Përdorimi i territorit | Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit | | |
| | | 1 vit | 2–5 vjet | 6–10 vjet |
| 1 | Tokë me bimësi pyjore, djerr | 15 000 | 13 000 | 10 000 |

**Vlerën e përdorimit lek/ha/vit________**

**Vlera per 1 vit**

Toke me bimesi pyjore 1.63 ha x 15 000 = 24 450 lekë

**Vlera per 2-5 vit**

Toke me bimesi pyjore 1.63 ha x 13 000 = 21 190 lekë

**Vlera per 6-10 vit**

Toke me bimesi pyjore 1.63 ha x 10 000= 16 300 lekë

PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Grupi I Punes
Qemal RUSTA
Klodian GANÇI
Anxhela DERVISHI
Bukuroshe ALLKA
Bardhyl SINA

**KRYETARI I BASHKISË**
**Arif TAFANI**
(Në mungesë dhe me urdhër)
Sekretari i përgjithshëm
**Mustafa ÇARÇIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA BELSH

Bashkia Belsh

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR ( sipas vkm 684 ,shtojca 15 lista e inventarit)

( Agropylltari)

Formulari 1

| ID. Prones | Ekon.Pyjore | Parc | Perb. grumb | Funksioni | Forma Qeverisjes | Te dhenat e grumbullit pyjor | | | | | | | Fuqia lendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Mosha | K.D | D mes | Lart. mes | Filizeria | Nen pylli | Katet | per ha | Total |
| EL56 00 | Rrase-Xherije | 19/a | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

Shenim: Ne mungese te planit te menaxhimit per Ngastra/nengastra 19/a ,duke u mbeshtetur te certifikata e cila eshte ranishte dhe jo pylle sipas vkm-se ,per pasoje nuk jane te shprehura te dhenat e mesiperme.

PLOTESOI: Qemal RUSTA Klodian GANÇI Anxhela DERVISHI Bukuroshe ALLKA Bardhyl SINA (Firma dhe vula)

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR ( sipas faktit)

( Agropylltari)

Formulari 1

| ID. Prones | Ekon.Pyjore | Parc | Perb. grumb | Funksioni | Forma Qeverisjes | Te dhenat e grumbullit pyjor | | | | | | | Fuqia lendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Mosha | K.D | D mes | Lart. mes | Filizeria | Nen pylli | Katet | per ha | Total |
| EL56 00 | Rrase-Xherije | 19/a | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

Shenim:Nga verifikimet ne terren ngastra/nengastra 19/a e transferuar si pyll nga vkm 684/2020
Rezulon qe mbulesa e kesaj parcele te jete e mbuluar me Bimesi pyjore si( drize ferre legum ,gram etj).

PLOTESOI: Qemal RUSTA Klodian GANÇI Anxhela DERVISHI Bukuroshe ALLKA Bardhyl SINA (Firma dhe vula)

Bashkia Belsh

# TABELA PERMBLEDHESE E VLERESIMIT FINANCIAR

Formulari4

( Agropylltari)

| Perdorimii territorit | Sip.Ha | Bashkia | Volumi m3 sipas asortimenteve | Vlera | | Gjatesia | Tarifa dhenie ne perdorim lek/ha/vit | | | ShumaII | TOTALII+II |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | lek/m3 | Shuma I | Perd.km | 1 | 2 deri5 | 6 deri10 | | Leke |
| **0** | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** | **11** |
| Bimesi pyjore | 1.63 | Belsh | | | | | 24 450 | 21 190 | 16 300 | | |
| **Gjithesej** | | | | | | | 24 450 | 21 190 | 16 300 | | |

PLOTESOI: Qemal RUSTA Klodian GANÇI Anxhela DERVISHI Bukuroshe ALLKA Bardhyl SINA (Firma dhe vula)

Bashkia Belsh

**LISTAE NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQEN/JEPEN NË PËRDORIM**

( Agropylltari)

| Nr. | ID pones | Ekonomia pyjore/Kullosore | Ng/ n/ngast. | Siperfaqja qe hiqet nga fondi pyjor/ kullosor | Siperfaqja qe jepet ne perdorim nga fondi pyjor/kullosor ha | Gjatesia ne perdorim km | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Rruge | Linje | Tubacion/ kanal |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 |
| 1 | EL56 00 | Rrase-Xherije | 19/a | | 1.63 | 0 | 0 | 0 |

Grupi I Punes
Qemal RUSTA
Klodian GANÇI
Anxhela DERVISHI
Bukuroshe ALLKA
Bardhyl SINA

**KRYETARI I BASHKISË**
**Arif TAFANI**
(Në mungesë dhe me urdhër)
Sekretari i përgjithshëm
**Mustafa CARÇIU**

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: Bashkia Belsh | DATE : 12.06.2024 | QELLIMI:Ndarje Pasurie

VENDNDODHJA

BASHKIA BELSH (F:SEFERAN) | DVASHK/ZVASHK ELBASAN | ZONA KADASTRALE 3272 | NUMRI PASURISE 122/1 | INDEKS K-34-112-45-B

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE: Ranishte | SIP.PASURISE= 142700 m2

X = 489667.896
Y = 4535165.103

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X = 490641.591
Y = 4535165.103




SHPJEGUESE

PASURIA ( 122/1 ) ME SIP. = 142700 m2

KERKOHET PER NDARJE PASURIE NE PRONESI BASHKIA BELSH.

KRIJOHET PASURIA "A" = 126436 m2

KRIJOHET PASURIA "B" = 16264 m2

X = 489667.896
Y = 4534458.187

SH 1:5000

X = 490641.591
Y = 4534458.187

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | V:- | | | | | Kjo pasuri e llojit "Ranishte" me siperfaqe 142700 m2 sipas |
| 2 | L:- | | | | | certifikates se pronesise leshura ne dt.19.10.2020 ne pronesi te |
| 3 | J:- | | | | | Bashkise Belsh,ndahet ne dy pjese.Pasuria A me sip.126436 m2 |
| 4 | P:- | | | | | dhe Pasuria B me sip.16264 m2 |

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI / MBIEMRI - FJORALB ALLA

LIÇENSA Nr T 1223/1 dt 26/11/2021

KOMPANIA /PERSON FIZIK

NIPTI M28218601J

NËNSHKRIMI

Fjoralb Alla — Digitally signed by Fjoralb Alla Date: 2024.04.23 13:49:14 +02'00'

REALIZOI PER A.SH.K

SPECIALISTI ____________

DR/A.SH.K ____________

NËNSHKRIMI ____________

KONFIRMOI

PERGJEGJESI / DREJTORI ____________

NËNSHKRIMI/VULA ____________

TEKNOLOGJIA E MATJEVE D-MATJE DISTANCASH

KODE PER TEKNOLOGJIINE E MATJEVE T-TERREN, Z-ZYRE, O-ORTOFOTO, G-GSP, S-STACIONTOTAL D-MATJE DISTANCASH

PERÇAKTIMI I KUFIRIT P- PB PERFAQESUESE BASHKIE

KODET PERCAKTIMIN E KUFIRIT P-PERFAQESUES I PRONAVE, K-KUFITARE TE GJITHE, KP-KUFITARE PJESERISHT PB-PERFAQESUES BASHKIE, HK- HARTE KADASTRALE

SHENIME TE VEÇANTA

NDARJE PASURIE

PRONARI / BASHKEPRONARET - DEKLARIM MBI MAREDHENIET ME KUFITARET

EMRI: BASHKIA BELSH

NËNSHKRIMI ____________

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BELSH**

**KESHILLI BASHKIAK BELSH**

**Nr — Prot** **Belsh më 23/04/ 2024**

**PROCES-VERBAL**

I mbledhjes së këshillit bashkiak të datës 27.03.2024 me 15 këshilltarë prezentë,në mbështetje të ligjit 139/2015 për vetëqeverisjen vendore. Njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar nëpërmjet formatit elektronik.

**<u>Janë prezent në mbledhje 15 këshilltarë:</u>**

1. **Erjon Qafa**
2. **Nexhip Elezi**
3. **Bujar Blloku**
4. **Aurela Hysa**
5. **Blerim Kuqja**
6. **Nertila Uruci**
7. **Naime Ibrahimi**
8. **Sami Uruci**
9. **Kujtim Dervishi**
10. **Gezim Gjoshi**
11. **Ismail Paja**
12. **Fadil Zdrava**
13. **Gazeli Hysa**
14. **Erion Gjoshi**
15. **Libeta Dragoti**

-Kryetari i keshillit bashkiak hap mbledhjen e keshillit.

-Diskutohet rendi i dites. Diskuton N.Uruci ne lidhje me rendin e dites dhe per mbledhjet e komisioneve te keshillit.

-Hidhet në votim rendi i ditës dhe miratohet me 11 vota pro.

-Diskutohet proces verbali i mbledhjes së kaluar nga ana e këshilltarëve.

-Kalohet për diskutim në pikën 3 të rendit të ditës për ndihmën ekonomike.Mbron përgjegjësja e zyrës E.Dervishi. Hidhet në votim Ndihma ekonomike dhe miratohet me 14 vota pro.

-Diskutohet pika nr.4 e rendit të ditës për Programin e transparencës në Bashkinë Belsh. Mbron Fatmira Broshka,punonjëja e zyrës për informimin publik. Diskuton E.Gjoshi në lidhje me kërkesat dhe përgjigjet ndaj qytetarëve.

-Hidhet në votim pika 4 dhe miratohet me 12 vota pro dhe 2 abstenim.

-Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës ,në lidhje me projekt vendimin për dhënien në përdorim të fondit pyjor /Kullosor. Diskuton N.Uruci,nëse është bërë dëgjesë publike nga ana e Bashkisë me banorët. Përgjigjet A.Dervishi që dëgjesën publike duhet ta organizojë këshilli bashkiak.

-Diskuton E .Gjoshi që të interesuarit të sjellin një shpjegim për arsyet që nuk duan që këto prona të jepen me qera.

-N.Uruci i drejtohet sekretarit të këshillit që të merret me organizimin e dëgjesës sipas ligjit.

-Diskuton kryetari i këshillit që ky projekt vendim të kalojë për dëgjesë publike pastaj të vijë në këshill bashkiak.

-Kalojmë te pika informacion nga Tatim Taksat

-Ditjon Pepa: Cdo gjë është sipas projekt vendimit që ka kaluar mbi taksat dhe tarifat .

-B.Kuqja: U tha gjatë diskutimit të taksave dhe tarifave që do të ketë rritje për 10 biznese.

-D.Pepa: Materiali për taksat dhe tarifat ju ka shkuar përpara këshilltarëve për të parë rritjen e taksave dhe tarifave.

-Diskutohet kërkesa e Adelina Dervishit. Propozon N.Uruci që kjo kërkesë të merret me seriozitet dhe nëse është e mundur të ndihmohet kjo familje. Kreytari i këshillit vendos që të ja kalojë përssri zyrës për verifikim.

-Diskutohet në lidhje me komisionet nga kryetarët e grupeve,se si do të funksionojnë. Diskuton E.Gjoshi që në pamundësi për të qënë fizikisht ,mbledhja e komisioneve të bëhet edhe online.

-Diskuton I.Paja që të merret më me seriozitet zgjedhja e kryetarëve të fshatrave dhe procesi që këshilli ka filluar.

-E Gjoshi: Jap dorëheqjen nga komisioni i Ekonomisë dhe propozoj si zëvëndësues z.Sami Uruci. Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro.

-N.Uruci : Kërkojmë informacion në mbledhjen e ardhshme për gjëndjen e shkollave dhe nr e Nxënësve,bashkë me numrin e mesuesve dhe edukatoreve në Bashkinë Belsh.

-B.Kuqja ; Kërkojmë informacion nga zyra e urbanistikes për terrenet sportive dhe kufizimet e tyre.

**Mbyllet mbledhja e këshillit me 3 vendime të miratuara.**

**Përgatiti :**

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Endri PEPA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BELSH**

**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr1528Prot.** **Belsh më:25/04 /2024**

## NJOFTIM PER DËGJESE PUBLIKE

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 18 pika 1 dhe pika 2,neni 54 germa (e) dhe në Rregulloren e Brendshme për funksionimin e Këshillit Bashkiak neni 158.

Këshilli Bashkiak Belsh fton banorët e fshatrave Hysë,Seferan,Kosovë dhe Dëshiran të bëjnë sygjerimet e tyre lidhur me projekt-vendimin e mëposhtëm:

**Projekt-vendim për dhënien në përdorim të pasurive :**

1. **Pasuria A pjese e pasurisë nr.185/1,ZK. 1146 me sipërfaqe 77000m2 me certifikatë pronësie të lëshuar më datë 06/11/2020 Nr. 21340 në pronësi të Bashkisë Belsh**
2. **Pasuria A pjesë e pasurisë nr.1/179, ZK.2237, me sipërfaqe 162 050m2 me certifikate pronësie të lëshuar më datë 18/12/2023.**
3. **Pasuria C pjesë e certifikatës së pronësisë me nr. Pasurie 42/3, ZK 1478 me sipërfaqe 30ha.**
4. **Pasuria A pjesë e certifikatës se pronësisë me nr.pasurie 42/3,ZK 1478,me sipërfaqe 46.25ha**
5. **Pasuria B pjesë e pasurisë Nr.122/1,ZK.3272, me siperfaqe 16 264m2**

(Paraqitur nga Drejtoria e zhvillimit te bujqësisë,pyjeve dhe mjedisit).

Dëgjesa publike do të bëhet më datë 15 / 05 / 2024 ora 14:00 në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak.

Gjithashtu ju ftojmë të bëheni pjesë e dëgjesës publike për projektvendimin e mësipërm nëpërmjet sygjerimeve tuaja në adresat elektronike:
http://bashkiabelsh.al/bashkiabelsh@hotmail.com

**KRYETARI I KËSHILLIT**
**Kujtim DERVISHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA BELSH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot në datën 15/05/2024, ora 14:00, në sallën e konferencave (Perla), në proçesin e "Dhënies në përdorim të pasurive" i paraqitur nga Drejtoria e zhvillimit të bujqësisë, pyjeve dhe mjedisit.

**Morën pjesë në takim:** Sekretari i përgjithshëm, Sekretari i Këshillit, Drejtoria e zhvillimit të bujqësisë, pyjeve dhe mjedisit dhe banorë të Bashkisë Belsh.

**Rendi i ditës:**"Dëgjesë publike për projekt-vendim për dhënien në përdorim të pasurive"

Takimi u hap me fjalimin e Sekretarit të Përgjithshëm me një falenderim për pjesëmarrësit dhe një përshkrim të përgjithshëm të takimit,Më pas fjalën e mori Drejtoria e Bujqësisë, duke bërë një përshkrim më të detajuar të projekt-vendimit.

Më pas iu dha fjala banorëve për tu bërë pjesë e diskutimit dhe për të dhënë opinionet dhe sugjerimet e tyre.

Disa nga paqartësitë dhe pyetjet e tyre ishin:

1.Pronat do të jepen me qera apo do të privatizohen?

2.Sa hektarë është pasuria e ndodhur në fshatin Kosovë?

3.Toka e ndodhur në Kosovë, është e mbuluar me të mbjella ose jo?

4.Pylli në fshatin Dëshiran do të mbetet i paprekur apo jo?

5.Këto prona do të jepen në përdorim me konkurim publik apo e vendos bashkia?

6.Ku ndodhet pjesa e Sëferanit që do të jepet në përdorim?

7.Projekt-vendimi dhe dokumentat e tij të afishohe edhe nëpër Njësi, që te jenë sa më shumë banorë në dijeni.

8.A mund të blihen këto pasuri?

Qytetarët morën përgjigjet për pyetjet e bëra përgjatë takimit nga personat përgjegjës

**Konceptoi:**Koordinatore për të Drejtën e Informimit dhe Konsultim Publik

Fatmira Broshka

Data 15.05.2024

Dëgjesa publike për projekt vendimin në përdorim të pasurive në pronësi të Bashkisë Belsh

| Nr. Rendor | Emër | Mbiemër | Firma | Fshati |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Endri Pepa | | | Belsh |
| 2 | Mustafa | Canaj | | Fragjun |
| 3 | Anxhelo | Dervishi | | Qafshkallë |
| 4 | Klodian | Gonxhi | | Shtith |
| 5 | Qamil Hysa | Stanaj | | |
| 6 | Bajram Hasa | Hysa | | |
| 7 | Delinist Hysa | | | Hordh |
| 8 | Shkëlqim Hyso | Hyzotoraj | | Stanaj |
| 9 | Fajar Fela | K.F. Dushk | | Dushkë |
| 10 | Erjon [illegible] | Qojo | | Belsh |
| 11 | Bexhet Kala | Morina | | |
| 12 | EDMOND PEPA | | | |
| 13 | Paulin | Brushlliu | | Dëshiran |
| 14 | Hajdar [illegible] | Shtith | | |
| 15 | Asim Cipi | Cërrik shkollë | | |
| 16 | Sejamin Kasa | MERHOJ | | |
| 17 | [illegible] | Trit | | |
| 18 | [illegible] | Erbo d. Sht | | |
| 19 | Shqelqim Zela | Seferie | | |
| 20 | Myftar Tcaso | Deferan | | |
| 21 | Dalip Idrizi | Idrizi | | Dragot |
| 22 | Kujtim | Sulce | | FERZ |
| 23 | Ilmas [illegible] | Shiefa | | Ferze |
| 24 | Gezim | Mullolli | | Fierze |
| 25 | Aldo Tolla | Tolla | | Fierze |
| 26 | Genci Kllogjeri | Kllogjeri | | Fierze |
| 27 | Willian [illegible] | Deshir | | |
| 28 | SHabon Lici | Erbe | | |
| 29 | | | | |
| 30 | Tefeter Mullolli | Mullolli | | |
| 31 | Sefedin Pepa | | | |






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BELSH**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr.1933 Prot.** **Belsh më: 31/05/2024**

## NJOFTIM PER KONSULTIM PUBLIK

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 18 pika 1 dhe pika 2,neni 54 germa (e) dhe në Rregulloren e Brendshme për funksionimin e Këshillit Bashkiak neni 158.

Këshilli Bashkiak Belsh fton banorët e fshatrave Hysë,Seferan,Kosovë dhe Dëshiran të bëjnë sygjerimet e tyre lidhur me projekt-vendimin e mëposhtëm:

**Projekt-vendim për dhënien në përdorim të pasurive :**

1. Pasuria A pjese e pasurisë nr.185/1,ZK. 1146 me sipërfaqe 77000m2 me certifikatë pronësie të lëshuar më datë 06/11/2020 Nr. 21340 në pronësi të Bashkisë Belsh
2. Pasuria A pjesë e pasurisë nr.1/179, ZK.2237, me sipërfaqe 162 050m2 me certifikate pronësie të lëshuar më datë 18/12/2023.
3. Pasuria C pjesë e certifikatës së pronësisë me nr. Pasurie 42/3, ZK 1478 me sipërfaqe 30ha.
4. Pasuria A pjesë e certifikatës se pronësisë me nr.pasurie 42/3,ZK 1478,me sipërfaqe 46.25ha
5. Pasuria B pjesë e pasurisë Nr.122/1,ZK.3272, me siperfaqe 16 264m2

**(Paraqitur nga Drejtoria e zhvillimit te bujqësisë,pyjeve dhe mjedisit)**

---

Konsultimi publik do të bëhet më datë 20.06.2024 ne të 4 fshatrat në oraret si më poshtë:

1. Deshiran, Ora: 9:00 ,Vendi Takimit: Lokali i Ferd Mjeshtrit
2. Hysë , Ora: 11:00 ,Vendi Takimit: Lokali i Lulzim Pepes
3. Seferan , Ora: 13:00 ,Vendi Takimit: Zejtaria
4. Kosovë , Ora: 15:00 ,Vendi Takimit: Lokali i Flamur Shehut

Drejtues të takimit do të jetë Komisioni i Bujqësisë dhe Pyjeve në këshillin Bashkiak Belsh me përbërje si mëposhtë:

1. Aleksander Peqini,Kryetar
2. Nexhip Elezi ,Anëtar
3. Fadil Zdrava, Anëtar

Gjithashtu ju ftojmë të bëheni pjesë e dëgjesës publike për projektvendimin e mësipërm nëpërmjet sygjerimeve tuaja në adresat elektronike:
http://bashkiabelsh.al/bashkiabelsh@hotmail.com

**KRYETARI I KËSHILLIT**
**Kujtim DERVISHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA BELSH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BELSH**
**KESHILLI BASHKIAK**

Belsh më 31.05.2024

**Njoftim per konsultim publik**

Seance konsultimi me publikun per dhenien ne perdorim për dhënien në përdorim të sipërfaqes së caktuar të fondit pyjor/kullosor publik në pronësi të bashkisë belsh.
Siperfaqes
**Baza Ligjore**
Ligji 139/2015 "Per Vetqeverisjen Vendore" neni 18 , , Rregullore e Këshillit për konsultimet me publikun nenet 7, 24, 27, 32, 35, 45, 46
Për dijeni: Kryetarit të Bashkisë

| | |
|---|---|
| **Titulli projektaktit:** | Projekt vendim për dhënien në përdorim të sipërfaqes së caktuar të fondit pyjor/kullosor publik në pronësi të bashkisë belsh. |
| **Takimi publik:** | Sipas kalendarit te publikuar |
| **Të ftuar:** | Banorë të fshatrave Hysë,Seferan,Kosovë,Dëshiran.Ekspertë të fushes dhe Grupe të tjera Interesi. |
| **Pjesëmarrës nga bashkia:** | Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë,Pyjeve dhe Mjedisit |
| **DREJTUES TE TAKIMIT** | **Komisioni i Bujqësisë dhe Pyjeve**<br>Aleksander Peqini, Kryetar<br>Nexhip Elezi ,Anetar<br>Fadil Zdrava , Anetar |

| | Nr. | Përshkrimi |
|---|---|---|
| 1 | Qëllimi i këshillimit publik | Qëllimi I këtij takimi është që të diskutohet me grupet e interesit. |
| 2 | Pershkrimi I ceshtjes | Dhënia në përdorim të pronave të fondit Pyjor/Kullosor në pronësi të Bashkisë Belsh,është një vendimarrje e rëndësishme dhe Pjesmarrja e publikut ne keto vendimarrje eshte teper e rendesishme per te vleresuar |

| | | |
|---|---|---|
| | | sa me mire prioritetet. |
| 3 | Disa pyetje nga Keshilli drejtuar grupit te Interesit | A jane paraqitur sakte prioritetet ne kete projekt vendim?<br>A jane te mjaftueshem indikatoret e raportit ekonomik paraqitur ne kete projekt? |
| 4 | Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve; | Komentet dhe rekomandimet tuaja mund të jepen direkt nëpërmjet **pjesmarrjes Suaj në takimet publik,** por në pamundësi për të marrë pjesë në këto konsultime, ato mund të dërgohen me **email**, mund të komentohen në faqen ëeb të Këshillit të Bashkisë ne **Rregjistrin Elektronik të Konsultimit Publik** tek projekt-akti "Për dhënien në përdorim të sipërfaqes së caktaur të fondit Pyjor/Kullosor në pronësi të Bashkisë Belsh", ose të dërgohen **me postë BRENDA DATËS 20.06.2024**<br>Email: Bashkiabelsh@hotmail.com<br>www.bashkiaBelsh.gov.al<br>Sekretari I Keshillit: Endri Pepa<br>Kordinator per Konsultimin publik:<br>Fatmira BROSHKA<br><br>Orari i punës i administratës së Bashkisë<br><br>E hënë – e premte<br>08:00 – 16:00<br><br>Adresa<br><br>Rruga Haziz Dervishi, Belsh |

| | | |
|---|---|---|
| | | Tel.: +355693720575<br>Email: fatmira.broshka@bashkiabelsh.gov.al |
| | Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion në lidhje me cështjen që konsultohet | Projekt-vendimin së bashku me relacionin shoqërues në lidhje me këtë projekt-vendim mund t'i gjeni në linkun https://bashkiabelsh.al/category/konsultime-publike/ |
| | Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet qe do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit | Konsultimi publik do të realizohet sipas Kalendarit të Konsultimeve Publike.<br>Pas realizimit të konsultimeve publike me komunitetin dhe grupet e interesit, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon :<br>1. Mbajtja e procesverbalit të cdo takimi publik dhe bërja publike e tyre.<br>2. Marrja e Rekomandimeve me postë dhe bërja e tyre publike.<br>3. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve, që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje.<br>4. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Bujqësisë dhe Pyjeve<br>5. Shqyrtimi nga ana e komisioneve (**mbledhjet e komisioneve janë të hapura për publikun sipas datës së parashikuar në kalendar**) të cdo rekomandimi dhe diskutimi i tij në komisione për |

| | | |
|---|---|---|
| | | të dalë me një vendim se cilat propozime mund të merren në konsideratë dhe cilat nuk mund të merren dhe për cfarë arsye.<br>6. Hartimi i **projekt-vendimit të përmirësuar** bazuar në rekomandimet e konsultimit publik.<br>7. Diskutimi dhe miratimi i aktit në **seancën e hapur** të Mbledhjes së Këshillit.<br>8. **Informimi i personave** që kanë dhënë rekomandime për aktin, për marrjen në konsideratë të rekomandimit ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tij.<br>9. **Publikimi** i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit<br>10. **Njoftimi** i administratës për aktin e miratuar<br>11. **Monitorimi** i zbatimit të tij |
| | Publikuar | 31.05.2024 |

**SEKRETARI I KESHILLIT**
**Endri PEPA**

**KRYETARI KESHILLIT**
**Kujtim DERVISHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA BELSH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BELSH**

**PROÇESVERBAL**

I mbajtur sot më datë 20.06.2024,ora 09:00, në fshatin Dëshiran (Bar-kafe Mjeshtri), në proçesin e "Dhënies në përdorim të pasurive" i paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve dhe Mjedisit.

**Morën pjesë në takim:**

Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve dhe Mjedisit ( Ervis Shehu, Klodian Ganç̧i, Anxhela Dervishi, Bukuroshe Allkja).

Komisioni i Bujqësisë dhe Pyjeve në Këshillin Bashkiak Belsh (Aleksandër Peqini, Nexhip Elezi, Fadil Zdrava).

Sekretari i Këshillit të Bashkisë Belsh (Endri Pepa).

Koordinatore për të Drejtën e Informimit dhe Konsultim Publik ( Fatmira Broshka).

Banorë të fshatit Dëshiran (afërsisht 50-60 banorë).

**Rendi i ditës:** "Dëgjesë publike mbi projekt vendimin për dhënien në përdorim/me qera të pronave në pronësi të Bashkisë Belsh".

Pa filluar ende prezantimi i pjesëmarrësve nga ana e institucionit të Bashkisë Belsh, edhe pa u bërë ende prezantimi i çështjes për të cilën ishte vendosur të kryhej ky konsultim publik me banorët e fshatit Dëshiran, pati një reagim të revoltuar dhe agresiv të banorëve pjesëmarrës.

Në pritje të qetësimit të situatës për të cuar deri në fund punën tonë për të cilën ishim nisur nuk ndodhi asgjë tjetër përveç sjelljeve ofenduese me tone të larta dhe agresive kundrejt nesh si punonjës të këtij institucioni, duke penguar kështu realizimin e takimit.

Për shkak të kësaj situate dhe gjithashtu për shmangien e situatave të tjera të ngjashme dhe të shqetësimit të kaluar në këtë takim, u konsultuam dhe vendosëm që mos ti vazhdonim më takimet pasardhëse në Seferan, Hysë dhe Kosovë deri në një moment të dytë.

**Konceptoi:**

Koordinatore për të Drejtën e Informimit dhe Konsultim Publik

Fatmira Broshka

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BELSH**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr. 2177 Prot.** **Belsh më: 28/06/2024**

**NJOFTIM PER SHTYRJE TË KONSULTIMIT PUBLIK**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 18 pika 1 dhe pika 2,neni 54 germa (e) dhe në Rregulloren e Brendshme për funksionimin e Këshillit Bashkiak neni 158,nisur dhe nga anullimi i takimeve të planifikuara për kosultim publik më datë 20.06.2024 për shkaqe objektive, Këshilli Bashkiak Belsh:

***Fton banorët e fshatrave Hysë, Seferan, Kosovë dhe Dëshiran të bëjnë sygjerimet e tyre lidhur me projekt-vendimin e mëposhtëm:***

**Projekt-vendim për dhënien në përdorim të pasurive :**

1. Pasuria A pjese e pasurisë nr.185/1,ZK. 1146 me sipërfaqe 77000m2 me certifikatë pronësie të lëshuar më datë 06/11/2020 Nr. 21340 në pronësi të Bashkisë Belsh
2. Pasuria A pjesë e pasurisë nr.1/179, ZK.2237, me sipërfaqe 162 050m2 me certifikate pronësie të lëshuar më datë 18/12/2023.
3. Pasuria C pjesë e certifikatës së pronësisë me nr. Pasurie 42/3, ZK 1478 me sipërfaqe 30ha.
4. Pasuria A pjesë e certifikatës se pronësisë me nr.pasurie 42/3,ZK 1478,me sipërfaqe 46.25ha
5. Pasuria B pjesë e pasurisë Nr.122/1,ZK.3272, me siperfaqe 16 264m2

**(Paraqitur nga Drejtoria e zhvillimit te bujqësisë,pyjeve dhe mjedisit)**

Konsultimi publik do të bëhet më datë 01.07.2024 për të 4 fshatrat në një ambjent të përbashkët në lagjen Hysë , Ora: 11:00 , Vendi Takimit: **Lokali i Lulzim Pepes**

Drejtues të takimit do të jetë Komisioni i Bujqësisë dhe Pyjeve në këshillin Bashkiak Belsh me përbërje si mëposhtë:

1. Aleksander Peqini,Kryetar
2. Nexhip Elezi ,Anëtar
3. Fadil Zdrava, Anëtar

Gjithashtu ju ftojmë të bëheni pjesë e dëgjesës publike për projektvendimin e mësipërm nëpërmjet sygjerimeve tuaja në adresat elektronike:
http://bashkiabelsh.al/bashkiabelsh@hotmail.com

**KRYETARI I KËSHILLIT**
**Kujtim DERVISHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA BELSH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

# PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2024,ora 09:00, në lagjen Hysë, në proçesin e "Dhënies në përdorim të pasurive" i paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve dhe Mjedisit.

**Morën pjesë në takim:**

Kryetari i Bashkisë Belsh (Arif Tafani)

Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve dhe Mjedisit ( Ervis Shehu, Klodian Gançi)

Komisioni i Bujqësisë dhe Pyjeve në Këshillin Bashkiak Belsh ( Nexhip Elezi, Fadil Zdrava).

Sekretari i Këshillit të Bashkisë Belsh (Endri Pepa).

Koordinatore për të Drejtën e Informimit dhe Konsultim Publik ( Fatmira Broshka).

Banorë të lagjes Hysë (afërsisht 25-30 banorë).

**Rendi i ditës:** "Dëgjesë publike mbi projekt vendimin për dhënien në përdorim/me qira të pronave në pronësi të Bashkisë Belsh".

Takimi u hap me prezantimin nga ana e anëtarëve të komisionit, të cilët bën një prezantim të përgjithshëm të projekt vendimit për personat pjesëmarrës.

Më pas fjala i'u dha Specialistit të Pyjeve pranë Drejtorisë së Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve dhe Mjedisit të Bashkisë Belsh, Klodjan Gançi i bëri një prezantim të detajuar të projekt vendimit të paraqitur duke saktësuar:

-vendodhjen e pasurive të cilat do të jepen me qira,

-benefitet që do të ketë Bashkia Belsh nga të ardhurat që do të fitohen nga dhënia me qira e këtyre pasurive duke i kthyer ato në investime dhe shërbime publike,

-dhënia e këtyre pasurive do jepet me ankand dhe do të jetë transparent për të gjithë,

Pas prezantimit të projektit fjalën e mori Kryetari i Bashkisë i cili foli për një fenomen të ndodhur për vite me rradhë në zonën e Dumresë atë të zaptimit të tokave të shtetit duke i shfrytëzuar ato kundrejt asnjë pagese, pasuri të cilat mund edhe të jepeshin me qira për ti sjellë të ardhura bashkisë. Gjithashtu ai cilësoi se bashkia disponon certifikatë pronësie për këto pasuri dhe arsyeja pse duhet ti japim ato me qira është përfitimi i të ardhurave dhe investimi i tyre në zone.

Më pas fjala i'u dha banorëve për të dhënë mendimet e tyre dhe për të bërë pyetjet që ata kanë. Disa nga pyetjet e tyre ishin:

Njeri nga banorët, Agron Hysa tha gjatë takimit se zotëron disa dokumenta për një pjesë pasurie të paraqitur në këtë projekt vendim, dokumenta të cilat i ka paraqitur edhe në Këshillin Bashkiak.

Gjithashtu ai tha që është në proçes gjyqësor për marrjen në pronësi të kësaj pasurie.

Njëra nga pyetjet ishte se: nëse Bashkia e jep me qira këtë pasuri per të cilën disponon certifikatë pronësie por edhe që qytetari Agron Hysa pretendon se ka dokumenta per këtë pasuri por edhe nëse fiton gjyqin për të marrë pronësinë e kësaj pasurie, të ardhurat e fituara nga qiraja nga Bashkia i kalojnë pronarëve?

Përgjigja e Kryetarit të Bashkisë për këtë pyetje por edhe si një përgjigje për qytetarin Agron Hysa është se nëse banorët fitojnë pronësinë e pasurisë të ardhurat qe i kalojnë Bashkisë do ti kaojnë më pas pronarëve.

Ndërsa njëri nga banorët pjesëmarrës tha se shumica e banorëve të lagjes Hysë janë në dijeni se kjo pasuri ka qenë gjithmonë në pronësi të qytetarit Agron Hysa.

Një nga shqetësimet e banorëve ishte se, kush ja ka dhënë tokat e zaptuara këtyre personave?

Përgjigja e Kryetarit të Bashkisë ishte se tokat janë zaptuar ndër vite nga më të "fortit", duke i shfrytëzuar edhe duke i "privatizuar" ato.

Pyetja tjetër ishte, se si i ka marrë Bashkia Belsh këto pasuri në pronësi?

Përgjigja e Kryetarit të Bashkisë ishte se Bashkia Belsh i ka marrë në pronësi këto pasuri si Pasuri Publike.

**Konceptoi:**

Koordinatore për të Drejtën e Informimit dhe Konsultim Publik

Fatmira Broshka

BASHKIA BELSH

**Dëgjesa Publike datë 01. 07. 2024**

**Listë Prezencë**

| Nr. | Emër | Mbiemër | Pro | Kundër | Firma |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Besim | Pepa | Pro | — | |
| 2 | Bujar | Hysa | Pro | — | |
| 3 | Shqiptim | Hysa | | jo | |
| 4 | Gëzeli | Hysa | | jo | |
| 5 | Bexhet | Hysa | | jo | |
| 6 | [illegible] | Hoxo | | joo | |
| 7 | | | | | |
| 8 | Klionda | Hysa | Pro | | |
| 9 | Fadil | Hysa | ~~Pro~~ | jo | |
| 10 | ELI | HYSA | Pro | | |
| 11 | Mesut | Kaçi | Pro | | |
| 12 | Sokol | Hysa | Pro | | |
| 13 | Remzi | Hysa | ~~Pro~~ | jo | |
| 14 | Çlirim | Hysa | Pro | | |
| 15 | Asqeri | Hysa | Pro | | |
| 16 | Alim Hysa | | Pro | | |
| 17 | ARMEND | HYSA | | jo | |
| 18 | Emirjon | Hysa | Pro | | |
| 19 | Fuzeli | Hysa | Pro | | |
| 20 | Marsel | Pepa | Pro | | |
| 21 | Flutur | Hysa | Pro | | |
| 22 | | | | | |
| 23 | | | | | |